

Në këtë kuadër, cilat kanë qenë marrëdhëniet mes mafies dhe masonerisë?

Është një tjetër kapitull shqetësues. Mjafton të mendosh vdekjet e Roberto Calvi-t, në 1982, dhe të Michele Sindona-s, më 1986, që kishin si sfond çështje që lidheshin me riciklimin e kapitaleve mafioze. Cosa Nostra e kishte shumë mirë parasysh forcën e masonerisë, e cila i jepte mundësinë që të zgjeronte sa më tepër lidhjet për të realizuar kështu qëllimet e veta. Vetëm disa krerë mafiozësh u lejuan të hyjnë në lozha, me kusht që mes dy betimeve të besnikërisë dhe fshehtësisë të mbizotëronte gjithnjë betimi mafioz. Me siguri, kanë bërë pjesë në masoneri, për shembull, Salvatore Bontade, “princi i Villagrazia-s”, kreu tjetër i një qarku mafioz, Pino Mandalari, tregtari në shërbim të sferës më të lartë të organizatës, Angelo Siino, njëkohësisht ndërlidhësi mes mafies, politikës dhe burokracisë administrative për dhënien e prokurimeve të veprave publike dhe mbledhësi i përfitimeve përkatëse, si dhe krerë të tjerë qarqesh, mes të cilëve Mariano Agate në Trapani, ku u zbulua lozha “Scontrino” dhe lozha të tjera varëse të masonerisë zyrtare, të ndotura nga prania e një rrjeti shumë të dendur biznesmenësh dhe mafiozësh.

Le të kthehemi tek Falcone, nga ku ia nisëm kur ju kërkova të më tregonit sesi arritët tek Komisioni Parlamentar Antimafie. Cila ishte marrëdhënia juaj me Falcone-n?

Mes nesh kishte një lidhje shumë të fortë, që karakterizohej nga respekti i ndërsjelltë. Kisha pasur mundësinë të vlerësoja profesionalizmin e Giovanni-t nga leximi i dokumenteve

përgatitorë të Supergjyqit, nga të cilat dilte në pah mprehtësia e tij hetimore dhe kërkimi ngulmues për prova të deklarimeve të bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Vendimi gjyqësor e vërtetoi plotësisht vlefshmërinë e punës së tij. Natyra e Giovanni-t ishte në përgjithësi ajo e një njeriu të ndrojtur, serioz, të heshtur, që dukej sikur nuk afrohej lehtë dhe që mund të merrte turr e të bëhej agresiv, nëse bashkëbiseduesi fliste në përgjithësi dhe nuk jepte informacione të sakta. Por, ama, kur ndiehej rehat – në familje, mes miqsh, me shoqëruesit, ndihmësat – Giovanni ndryshonte krejtësisht: në ato çaste dinte të tregohej shumë i dashur, i këndshëm, e madje edhe shakaxhi. Cilësia e tij më e dukshme? Ndoshta aftësia për të vuajtur, për të duruar më shumë se të tjerët, për të mos u dorëzuar kurrë.

Një cilësi që e dëshmoi veçanërisht kur u sulmua edhe brenda Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Edhe pas dënimeve të panumërta me burgim të përjetshëm dhe me mijëra vite burgu të dhëna me vendim të shkallës së parë të Supergjyqit, vazhdoi si për Falcone-n ashtu dhe për Borsellino-n, veprimtaria e pabesueshme e delegjtimimit të tyre personal dhe profesional. Një veprimtari që nuk do ta çudiste Buscetta-n, i cili e njihte me rrënjë e dhëmballë aftësinë e depërtimit të mafies në institucione.

Në një klimë të ndezur që më përpara, shpërtheu dhe një polemikë e ashpër e nxitur nga Leonardo Sciascia me një artikull të publikuar tek “Corriere della sera” më 10 janar 1987, në të cilën Borsellino etiketohej si “profesionist i antimafies” sepse, me rastin e emërimit të tij si Kryeprokuror i Marsalës,

ia kishte zënë vendin një kolegu njëzet vjet më të madh në moshë. Kështu pra, Borsellino paraqitej si një karrierist që, duke përfituar nga lufta kundër mafies, kishte arritur të anashkalonte kriterin e vjetërsisë të zbatuar deri atëherë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Sciascia ishte sigurisht shumë i vlerësuar për denoncimet e guximshme që kishte bërë kundër mafies, në kundërshtim me heshtjen e shumicës së intelektualëve. Librat e tij “Siçilia si metaforë” dhe “Dita e kukuvajkës”, nga i cili pastaj Damiano Damiano u frymëzua për një nga filmat e tij më të mirë, ishin tekstet themelore për të kuptuar dukurinë mafioze. Por me atë artikull kishte dashur të demaskonte me ashpërsi një klimë që mbizotëronte në Palermo, sipas së cilës shumë personazhe u bënë “të paprekshëm” meqenëse ishin “profesionistë të antimafies”. Shkrimtari e kishte fjalën sidomos për disa përfaqësues të botës politike, disa anëtarë të komiteteve të ndryshme të antimafies. Por përmendja e Paolo Borsellino-s shkaktoi polemika të ethshme deri në atë pikë sa Sciascia u sulmua me fyerje të rënda nga një prej komiteteve antimafie, i cili e cilësoi si një farë “firifiu”, duke përdorur një prej cilësimeve të sajuar prej vetë shkrimtarit siçilian për të përkufizuar një njeri me vlera të rëndomta.

Borsellino nuk iu kundërvu, madje u përpoq ta shfaqësonte Sciascia-n, duke thënë se do të kishte dashur ta njihte atë “shkarravinë që kishte arritur të përpunonte besimin e mirë të shkrimtarit”, duke i dorëzuar një kopje të procesverbalit të KLD.

Një vit më pas, gjatë një darke që mund ta quajmë si darkë pajtimi, ku ishin të pranishëm Falcone, Borsellino dhe Sciascia, arritën që së bashku t’i sqaronin qëndrimet e tyre duke treguar

respekt dhe konsideratë të ndërsjelltë. Shkrimtari shfaq vlerësimin e tij të madh për punën e ekipit të antimafies ndërsa gjyqtari i shprehu shkrimtarit mirënjohjen e thellë për veprën e tij letrare, duke pohuar se kishte arritur ta kuptonte mafien nëpërmjet librave të tij. E ka kujtuar këtë ngjarje Agnese Borsellino në një intervistë të Attilio Bolzoni-t të botuar tek “Republika” më 28 dhjetor të 2006.

Po le të kthehemi tek Falcone. Në tetor të 1987 u hap gara për zëvendësimin e Antonino Caponnetto-s në krye të Zyrës së Hetuesisë të Palermos. Falcone duhet të ishte natyrshëm pasardhësi i tij. Por, me një votim që mund të quhej i tërthortë, në janar të 1988, na mbiu më i vjetri Antonino Meli. Borsellino e kundërshtoi zgjedhjen e KLD, duke mos ngurruar ta quante “Judë” atë që ia kishte gënjyer mendjen ekipit të antimafies se mund ta mbante nën mbikëqyrje Giovanni Falcone-n.

Borsellino e shndërroi dhe në një çështje mediatike, me sa më kujtohet.

Është e vërtetë. Borsellino e bëri të bujshëm “çështjen Palermo”, për të shpëtuar mikun e tij Giovanni nga veçimi në të cilin ishte vendosur që prej marrjes së drejtimit të zyrës nga gjyqtari relatues Meli, i cili po i copëzonte të gjitha hetimet mbi mafien, duke ua deleguar prokurorive të tjera ose duke ua caktuar gjyqtarëve që nuk bënë pjesë në ekipin e Falcones.

Me rastin e paraqitjes së një libri mbi procesin e mafies argentinase, në oborrin e kishës së Shën Nikollës në Agrixhento, Borsellino denoncoi haptazi, me zërin e tij të vendosur e të shtruar, faktin se në Palermo po përgatitej shpërbërja e ekipit të antimafies, duke bërë kështu të ditur publikisht shqetësimet që i kishte besuar Giovanni Falcone

mbi ecurinë e punës së vet. Pak ditë më vonë, në dy intervista tek “Unità” dhe “Repubblica”, të dyja më datë 20 korrik 1988, nuk ngurroi ta drejtonte haptazi gishtin akuzues kundër Melit, duke e quajtur përgjegjës kryesor të shkatërrimit të punës në grup e cila, duke përqëndruar hetimet e Cosa Nostra-s në Palermo, kishte bërë të mundur gjyqet kundër mafies.

Paolo Borsellino e përjetoi të gjithë ngjarjen si një padrejtësi të madhe. Pikërisht ai që, me kurajë, donte t’i bënte njerëzit të kuptonin rëndësinë e disa zgjedhjeve juridike, u gjend në mënyrë paradoksale si i akuzuar, duke rrezikuar edhe marrjen e ndonjë mase disiplinore sepse kishte shpifur kundër gjyqtarit Meli dhe, për më tepër, kishte përdorur për këtë gjë një rrugë jo institucionale siç ishte mass media.

Giovanni Falcone, në një letër drejtuar KLD, shkruante: “Më është dashur të përballoj shpifje të pështira dhe një fushatë baltosjeje në një shkallë të padëgjuar ndonjëherë, të cilave nuk u jam kundërvënë sepse mendoja, ndoshta me pa të drejtë, se roli im më detyronte të heshtja. Por tani situata është krejtësisht e ndryshme dhe vetpërmbajtja ime nuk ka më asnjë kuptim. Ajo të cilës i druhesha tashmë ka ndodhur: hetimet në proceset kundër mafies janë zënë ngërç, dhe mekanizmi tepër i brishtë, i ndërtuar nga i ashtuquajtimi grupi antimafie i zyrës së Hetuesisë së Palermos, tashmë është paralizuar. Paolo Borsellino, miqësinë e të cilit e kam për nder, ka dëshmuar edhe një herë përgjegjësinë ndaj shtetit dhe guximin e tij, duke denoncuar publikisht lëshimet dhe zvarritjet në luftën kundër fenomeneve mafioze, veprime që janë para syve të të gjithëve”. Pastaj kërkoi që të shpërngulej në një zyrë tjetër dhe të merrte menjëherë pushimet e lejes.

Më në fund, vendimi i KLD, i shpallur më 14 shtator 1988,

qe vendimtar: Borsellino u rehabilitua sepse kishte ngritur një problem të vërtetë, edhe pse me pasaktësira dhe me mjete të papërshtatshme: Falcone-s iu besuan sërish hetimet antimafie dhe Meli mori urdhërin zyrtar për të qenë kreu i padiskutueshëm i zyrës së hetimeve.

Në vitet pas Supergjyqit Falcone u akuzua madje se kishte mbuluar hetimet mbi vrasjet politike, se kishte fshehur provat në sirtare dhe se nuk i kishte nxjerrë për të mos njollosur kokat e mëdha të politikës së asaj kohe. Herë pas here u damkos si komunist, pasues i Andreotit apo si socialist. Po në këtë periudhë organeve institucionale u erdhi një letër anonime, nga një farë “Korbi”, identiteti i të cilin nuk u zbulua kurrë, ku arrihej deri aty sa fajësohej Falcone dhe bashkëpunëtorët e tij më të afërt, se i kishin dhënë leje “të penduarit” Salvatore Contorno për të vrarë.

Në verën e 1989, në periferi të Palermos, në sharrën e Addaura-s, përpara vilës së plazhit ku Falcone kalonte verën, u zbulua një çantë me një pajisje eksplozivi. Ato ditë ndodheshin në Palermo dy gjyqtarë zvicerianë, një prej tyre Carla Del Ponte, të cilët ishin angazhuar bashkë me Falcone-n në hetimet mbi lëndët narkotike dhe pastrimin e parave të pista. Qëllimi për t’i marrë jetën Falcone-s, që lahej pikërisht në atë pjesë të bregut, dukej qartazi, por edhe në atë rast pati nga ata që përfituan nga ngjarja për të shpifur në kurriz të tij, duke hamendësuar se bëhej fjalë për diçka të organizuar prej vetë Falcone-s me qëllim që të përshpejtonte dhe lehtësonte emërimin e tij si ndihmës prokuror në Palermo. Falcone i rrëfeu një miku dhe kolegu të vet se ideja e atentatit du-het të ishte pjellë e “mendjeve shumë të stërholluara”, duke hedhur dyshimet në lidhjet e Cosa Nostra-s me grupe jashtë saj.

Por “persekutimi” i Falcone-s nuk mbaroi me kaq, apo jo?

Pikërisht. Në 1990 Falcone kandidoi për në KLD, duke marrë një goditje tjetër. E hodhën poshtë vetë shokët e tij. Një tjetër pabesi. E pastaj, kur, më 1991, pranoi ftesën për të punuar në Ministrinë e Drejtësisë me Claudio Martelli-n, e akuzuan se ishte vënë në shërbim të tij për të cënuar pavarësinë e drejtësisë. Ndërkohë që diskutohej për Prokurorinë Kombëtare Antimafie, një anëtar i rëndësishëm i KLD, Alessandro Pizzorusso, i zgjedhur nga Parlamenti me propozim të PDS, shkroi një artikull tek “Unità” me 12 mars 1992, me titull: “Falcone kryeprokuror? Nuk mund ta bëjë, ua them unë përse!” ku pohohej se vërtet Falcone ishte më i përshtatshmi për të mbuluar detyrën e Kryeprokurorit Kombëtar Antimafie, por KLD nuk mund ta emëronte, sepse ai ishte i lidhur me pushtetin politik që synonte të godiste pavarësinë e drejtësisë. Dhe me të vërtetë, KLD zgjodhi Agostino Cordova-n. Për Falcone-n që goditja e tretë. Por izolimi dhe deligitimi i tij që vepër edhe e vetë gjyqtarëve. Rreth gjashtëdhjetë prej tyre, mes të cilëve edhe disa që i kishin qëndruar shumë afër, nuk ngurruan të firmosnin publikisht, më 28 tetor 1991, një letër kundër zgjedhjes së tij si Kryeprokuror, duke e përcaktuar si “një instrument të papërshtatshëm, të rrezikshëm, joproduktiv”. Për fat të keq u vërtetua paralajmërimi i Buscetta-s: “Po ju paralajmëroj, zoti gjyqtar: pas këtyre hetimeve ndoshta ju do të bëheni i famshëm, por jeta juaj do të vihet në shënjestër. Do të përpiqen t’ju shkatërrojnë fizikisht dhe profesionalisht. Mos harro se llogaria me Cosa Nostra-n nuk mbyllet kurrë”.

Claudio Martelli kishte zhvilluar një takim të gjatë me

Falcone-n më 1987-n, kur ishte zgjedhur deputet në Siçili në listat e PSI. Që atëherë Falcone e kishte sqaruar se mafia nuk ishte një organizatë e zakonshme kriminale dhe i kishte treguar mjetet dhe strategjitë politike që duhej të vinte në veprim për t'iu kundërvënë.

Megjithë suksesin e madh në luftën kundër mafies, të dëshmuar dhe nga përfundimi i Supergjyqit, klima politike në Palermo ishte turbulluar thellësisht: siç u tha më sipër, kishin filluar të ngriheshin fushata shpifjesh kundër “profesionistëve antimafie”; kryetari i bashkisë Leoluca Orlando me të atin jezuit Ennio Pintacuda udhëhiqte bujshëm betejat kundër Cosa Nostra-s dhe në të njëjtën kohë lëshonte akuza të hidhura kundër Falcone-s, dhe vetë Falcone ishte i detyruar të mbrohej në KLD ndaj akuzave të rënda dhe të turpshme të ngritura kundër tij. Corrado Carnevale, Kryetar i Shkallës të Parë të gjyqimit penal të Kasacionit, në të cilin miratoheshin automatikisht kërkesat për prishje vendimi të avokatëve të mafiozëve, të bazuara shpesh në interpretime formale dhe të ngurta, kishte ndihmuar për nxitjen e anulimit të shumë dënimeve dhe për pasojë nxjerrjen prej burgut të krerëve të rëndësishëm të mafies. Duhet vënë në dukje angazhimi i madh i dy ministrave të qeverisë së Andreotit, Ministrit të Drejtësisë, Claudio Martinelli-t dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, Vincenzo Scotti-t, të cilët, me një dekret-ligj të guximshëm e të kundërshtuar disa herë, nëpërmjet të cilit interpretohej një ligj mbi llogaritjen e kohës së arrestimit (i ashtuquajtur “dekret antimafie” apo “dekret antikrim”), bënë të mundur sërish arrestimin e rreth njëzet krerëve mafiozë, të liruar para dymbëdhjetë ditësh, mes të cilëve dhe Michele Greco-n, “babain” e mafies. Ky veprim u përpunua në mënyrë tepër të

fshehtë përpara se të çohet në Parlament për miratim, gjë që përbën dhe një rast të rrallë në Itali, duke dëshmuar kështu edhe një herë se ligjshmëria antimafie kërkon mbështetje nga vullneti i vendosur politik.

Përse Falcone zgjodhi të shkonte në Ministrinë e Drejtësisë në Romë?

Pas disa dështimeve, Giovanni arriti më në fund të fitonte detyrën e shumëdëshiruar të zëvendës prokurorit në Palermo, por nuk arriti të kishte atë pavarësi drejtimi të hetimeve mbi mafien që i kishin premtuar. Për këtë arsye, sipas meje, por edhe ngaqë mendonte se nga Roma mund të ndihmonte në mënyrë aktive kundër mafies nëpërmjet administratës qendrore të drejtësisë dhe reformave në fushën ligjore, e pranoi propozimin e ministrit Martelli për të marrë detyrën e drejtorit të përgjithshëm të çështjeve penale. Kjo zgjedhje që bëri i shkaktoi kritika të tjera dhe çoi në shpërthimin e polemikave: u akuzua se kishte braktisur frontin e luftës dhe ishte struktur në "Pallat". Në mënyrë spekulative, Martelli u etiketua sikur kishte pasur për qëllim t'i bënte nder mafies duke e hequr qafe Falcone-n.

Si lindi ideja e Prokurorisë Kombëtare Antimafie?

Falcone e poqi idenë duke u bazuar pikërisht në përvojën e fituar në hetimet mbi Cosa Nostra-n dhe duke marrë parasysh funksionin e drejtuesit të hetimeve nga ana e kryeprokurorit në zbatim të kodit të ri të procedurës penale. Ideja e një organizmi kombëtar që do të bashkërendonte hetimet mes prokurorive të ndryshme lindi nga bindja se organizatat

kriminale ishin si një e vetme dhe se mafia siçiliane, 'ndrageta kalabreze dhe kamorra napoletane kishin lidhje të ngushta si mes tyre ashtu dhe me organizatat kriminale të vendeve të tjera për trafikun e lëndëve narkotike dhe për pastrimin e parave. Këto ishin dhe sythet nga ku mbiu projekti i Prokurorisë Kombëtare Antimafia, edhe pse pjesa më e madhe e gjyqtarëve e konsideronin të papërshtatshme, të rrezikshme, joproductive. Falcone deshi që lindja e këtij organizmi ligjor të shoqërohej me krijimin e Drejtorisë Hetimore Antimafia (DIA), e cila u krahasua njëfarësoj me FBI e famshme. Ky organizëm i përbashkët, i përbërë nga policia, karabinieria dhe policia financiare, pas një debutimi të shkëlqyer, të karakterizuar nga menaxhimi i efekshëm i bashkëpunëtorëve të parë të rëndësishëm të drejtësisë pas masakrës së 1992-1993, do t'i duhej të merrej në mënyrë ekskluzive, sipas ligjit hetimor, me të gjitha hetimet antimafie. Në të vërtetë nuk ia doli kurrë të shprehte tërësisht fuqinë e vet, sepse ndikohej nga klima konkurruese mes tri forcave të policisë, të cilat e vazhduan angazhimin e luftës kundër kriminalitetit të organizuar duke forcuar shërbimet qendrore përkatëse.

Kur erdhi puna për të zgjedhur se cili duhet ta mbulonte, për herë të parë, detyrën e Prokurorit Kombëtar Antimafie, KLD-ja e tregoi sërish veten dhe, duke e poshtëruar dhe një herë Falcone-n, zgjodhi, siç e thamë, prokurorin e Palmit, Agostino Cordova-n, i cili ishte dalluar për hetimet mbi masonerinë. Por ministri Martelli, që kishte pasur mundësi të njihje nga afër profesionalizmin e rrallë të Falcone-s, fitoi kohë, duke vonuar të ashtëquajturin "koncert", domethënë miratimin e Drejtësisë siç parashikohej nga ligji. Pas vdekjes së Falcone-s, në maj të 1992, afatet e konkurrimit u rihapën

me arsyen se shumë gjyqtarë nuk kishin paraqitur kërkesë për t'i hapur udhë Falcone-s, i cili mbahej si më i përshtatshmi për të marrë atë detyrë. KLD emëroi atëherë Bruno Siclari-n, i cili ishte ndërkohë Kryeprokuror i Palermos.

Falcone nuk pati shumë kohë në dispozicion, si drejtor i çështjeve penale.

Vetëm një vit, për fat të keq. E megjithatë përpara se pesë-qind kile eksploziv ta hidhnin në erë në Capaci, Falcone arriti të ndërmerre shumë nisma, duke më kërkuar mua, që në atë kohë isha këshilltar pranë Komisionit Parlamentar Antimafie, që të bashkëpunoja me të.

Në atë periudhë Komisioni ishte i alarmuar nga shfuqizimi i vazhdueshëm i vendimeve në lidhje me mafiozët nga ana e Shkallës së Parë të Gjykatës së Kasacionit, e drejtuar nga Corrado Carnevale. I verifikoi kësisoj me hollësi këto vendime, duke nxjerrë në pah disa gabime vlerësimi. Kjo gjë e shtyu ministrin Martelli “ta këshillonte” Kryetarin e Gjykatës së Kasacionit të kryente qarkullimin e gjyqtarëve të seksioneve të ndryshme, gjë që çoi në një përbërje të re të kolegjit, i cili duhej të thoshte fjalën e vet për kërkesat e të dënuarve të Supergjyqit kundër mafies. Një mënyrë elegante për të penguar atë qark të shkurtër të mbrapshtë që rrezikonte t'i shfuqizonte përfundimet e mëdha të arritura nga hetimet mbi Cosa Nostra-n. Gjykata e Lartë përbënte pa dyshim, instancën e fundit në dispozicion të klaneve, jo vetëm nga pikëpamja juridike, dhe sigurisht nuk qe një rastësi që zëvendës prokurori i përgjithshëm pranë Kasacionit, Antonino Scopelliti, u vra barbarisht në Kalabri më 9 gusht 1991. Edhe pse shkaqet e